



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**GRAMSH**

Nr. 228/3 Prot.

Gramsh, më 05.02.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 10 , datë 30.01.2026**

**MBI**  
**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE**  
**KULLOSOR PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH.**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, në mbështetje të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni 25 pika 1, të ligjit nr.111/2024, datë 31.10.2024 “Për disa ndryshime ne ligjin nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar, bazuar në nenin 54 gërma “e”, gërma “k”, nenin 3 gërma “ç”, nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4 të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Ministrisë së Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, në zbatim të VKM-së nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, në VKM-në nr.267, datë 27.04.2023 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.559, datë 29.07.2022 e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, në VKM-në nr.467, datë 31.04.2025 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”, Këshilli Bashkiak Gramsh;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullor publik që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Gramsh.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**  
**Xhulia GJINI**

